

# RELACION

## PËR

### **PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9920, DATË 19.5.2008, “PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Propozimi i projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës. Ky projektligj është pjesë e paketës fiskale 2019.

Ndryshimet e propozuara synojnë:

- lehtësimin e procedurave tatimore për tatimpaguesit;
- mbylljen e hapësirave për shmangie tatimore dhe evazion;
- lehtësimin e komunikimit me tatimpaguesit, duke përdorur më gjerë komunikimin elektronik;
- lehtësimin e komunikimeve ndërmjet agjencive shtetërore, si Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Qendra Kombëtare e Biznesit, parë kjo në funksion të reduktimit të barrës administrative;
- përmirësimin e rregullave të regjistrimit, të pajisjes me NIPT/NUIS dhe çregjistrimit të personave fizikë tregtarë.

Objektivat e synuara lidhen me:

- reduktimin e kostove të përmbushjes nga biznesi;
- reduktimin e kostove të administrimit;
- deklarimin dhe pagimin e tatimit nga çdo tatimpagues sipas përcaktimit ligjor duke eliminuar përdorimin e mekanizmave dhe veprimeve me qëllim shmangien e tatimit.

#### **II. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Ndryshimet e propozuara në këtë projektligj lidhen me thjeshtësimin e procedurave tatimore në zbatimin e legjislacionit tatimor. Gjithashtu, ky projektligj synon të rregullojë disa mangësi, që ende vërehen në praktikën e zbatimit të legjislacionit tatimor dhe lënë hapësirë për shmangie të deklarimit

dhe pagesës së detyrimeve reale nga tatimpaguesit. Ndryshimet e propozuara synojnë gjithashtu përmirësimin e rregullave të regjistrimit dhe të pajisjes me NIPT/NUIS të personave fizikë tregtarë, për të administruar këtë kategori tatimpaguesish në deklarimin e saktë të të ardhurave të realizuara, kur fiktivisht ndajnë aktivitetin vetëm me qëllimin e shmangies së tatimit, duke u regjistruar me më shumë se një NIPT/NUIS.

Në propozimet e paraqitura në këtë projektligj synohet gjithashtu përdorimi i mënyrave alternative të vlerësimit tatimor, kur nga administrata tatimore konstatohet se tatimpaguesi kryen veprime apo transaksione, të cilat synojnë përfitimin e një avantazhi tatimor në kundërshtim me legjislacionin tatimor dhe rezultojnë fiktive mbi prova dhe fakte.

Një ndryshim tjetër, lidhet me qartësimin e procedurave të njoftimit për pagesën e detyrimeve tatimore, të pagesës dhe rradhës së pagesave, duke e bërë më të thjeshtë zbatimin e këtyre procedurave në praktikë. Në projektligj propozohen edhe rregullime të procedurës së deklarimit të detyrimit tatimor të pambledhshëm dhe hapave që do të ndiqen nga administrata tatimore në zbatimin e procedurës.

Gjithashtu, ndryshime propozohen edhe në trajtimin e kundërvajtjeve administrative, ku vlen të theksohet një shtesë me rëndësi në nenin 124, që në rast se tatimpaguesi pranon vlerësimin tatimor dhe e paguan detyrimin, gjoba në këtë rast reduktohet me 30 për qind.

### **III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

### **IV. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian.

### **V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Konkretisht, ky projektligj parashikon, si më poshtë vijon:

Nenet 1 e 2 parashikojnë pajisjen me vetëm një NIPT të personit fizik (mund të pajiset me NIPT-e sekondare nëse hap veprimtari të tjera), me qëllim shmangien e keqpërdorimit të tarifave të ligjit dhe të tatimit.

Neni 3 parashikon disa ndryshime dhe shtesa në nenin 44 të ligjit, me qëllim shmangien e mospagimit të tatimeve, duke përdorur mekanizmin e pezullimit të veprimtarisë në çdo kohë. Gjithashtu, detajon dënimet në lidhje me transaksionet e tatimpagueseve në regjistrin pasiv me ata aktivë, apo, në të kundërtën, të tatimpaguesve aktivë me ata pasivë.

Neni 4 parashikon të përmirësojë procedurat e çregjistrimit të tatimpaguesve nëpërmjet riformulimit të nenit 45, me synim lehtësimin e tyre. Gjithashtu, saktëson e qartëson detyrat e enteve publike të përfshira në këtë proces.

Neni 5 korrekton shumën për të cilën bëhet vlerësimi tatimor, nga 100 lekë në 1 000 lekë, pasi konsiderohet shumë e ulët, duke krijuar vlerësime jothelbësore në numër të konsiderueshëm.

Neni 6, parashikon shtimin e një paragrafi (shkronja “f”) në nenin 71, për të shmangur rastet kur biznesi ndahet fiktivisht me qëllim përfitimin e avantazheve fiskale.

Neni 7 parashikon shtimin e një neni (Neni 71/2) si nen i përgjithshëm që lejon administratën tatimore të rikarakterizojë transaksionet dhe të llogarisë detyrimin ligjor, kur, me veprimet apo transaksionet e kryera, tatimpaguesi ka synuar të shmangë ligjin, duke prezantuar pamje të rreme të veprimtarisë së tij. Gjithashtu, është parashikuar që, në këto raste, barrën e provës e mbart kryesisht administrata tatimore.

Nenet 8 e 9 janë nene rregulluese, që mundësojnë përshtatjen e situatave të pagesave me sistemin tatimor.

Neni 10 parashikon riformulimin e pikës 1, të nenit 89, me synimin për zgjerimin e komunikimit me tatimpaguesit, duke përfshirë si mënyrë komunikimi dhe komunikimin elektronik.

Neni 11 parashikon që në nenin 90 të përmirësojë dhe të saktësojë procedurat e adresimit të detyrimeve tatimore të pambledhshme.

Neni 12 parashikon ndryshim në pikën 7 dhe shtohen pikat 8 dhe 9, të nenit 103 të ligjit.

Neni 13 parashikon heqjen e parapagimit të kamatëvonesave si kusht në procedurën e ankimit tatimor, masë e cila lehtëson barrën e ankimuesve për qëllime të kësaj procedure.

Neni 14 parashikon shtesën e pikës 3, në nenin 115 të ligjit, që përcakton si deklaram të pasaktë rastin kur, si rezultat i kontrollit tatimor, bëhet rivlerësim në ulje i tepricës kreditore, si dhe nivelin e gjobës në këtë rast.

Neni 15 nëpërmjet shtimit të nenit 115/2, parashikon vendosjen e penaliteteve për personat juridikë, kur nuk njoftojnë administratën tatimore në lidhje me ndryshimet e pronësisë, sipas kërkesave të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

Neni 16 parashikon shtimin e paragrafit të dytë në pikën 1, të nenit 124, i cili incentivon tatimpaguesit që pranojnë vlerësimin tatimor dhe e paguajnë atë menjëherë, duke zbritur nivelin e gjobës me 20 %.

Neni 17 parashikon shtimin e një fjalie në shkronjën “ç” të nenit 129 të ligjit, që limiton gjobën për bankat dhe institucionet financiare në rast moszbatimi të urdhërblokimit, deri në shumën e tatimit të urdhëruar për t’u bllokuar.

Neni 18 parashikon që ministri përgjegjës për financat të nxjerrë akt nënligjor për kriteret e zbatimit të nenit 71/2 të ligjit.

Neni 19 parashikon botimin në “Fletoren zyrtare” dhe hyrjen në fuqi më 1 janar 2019.

## **VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTAKTI**

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Qendra Kombëtare e Biznesit.

## **VII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT**

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes ka përcjellë mendimet e grupeve të interesit, të cilat, pasi u shqyrtuan me vëmendje nga ana jonë, u reflektuan pjesërisht në përmbajtjen e projektligjit.

## **VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Ky projektligj nuk paraqet efekte në buxhetin e shtetit.

## **KËSHILLI I MINISTRAVE**